



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikimi Teknik - TP 31

Katalogu i pyetjeve të testit të njohurisë për operim me Sistem të mjetit ajror pa pilot (SAP)



Material udhëzues

Parathënie

Ky material udhëzues është i karakterit edukativ dhe ka për qëllim përgatitjen e kandidatëve të cilët i nënshtrohen pjesës teorike të testit të njohurisë për operim me Sistem të mjetit ajror pa pilot (SAP).

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) që nga viti 2017, ka publikuar dhe përditësuar Rregulloret nga domeni i Sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Rregullore (AAC) Nr. 01/2026 mbi Rregullat dhe procedurat e operimeve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot është në fuqi nga muaji janar i vitit 2026. Sipas kësaj Rregulloreje pronari ose operatori i SAP të Kategorive A2, A3 dhe A4 duhet të jetë mbi 16 vjeç, gjendje të mirë shëndetësore dhe të ketë kaluar testin e njohurisë mbi çështjet e adresuara me këtë Rregullore.

Kandidati duhet të parashtroj kërkesë me shkrim në AAC për të hyrë në provimin e njohurive sipas Rregullore (AAC) Nr. 01/2026, dhe duhet të paguaj tarifën prej:

- (a) 25 € për Kategorinë A2,
- (b) 50 € për Kategorinë A3,
- (c) 75 € për Kategorinë A4.

Testi i njohurive do të përmbajë pyetje të ndryshme dhe organizohet në ambientet e AAC-së. Kandidati kalon me sukses testin e njohurive, nëse iu është përgjigjur saktë të paktën 75% të pyetjeve.

Nëse kandidati nuk e kalon testin e njohurive, ai/ajo mund të aplikojë për rivlerësim, por jo para se të kenë kaluar 30 ditë nga testi i fundit i njohurive.

Kandidati i cili kalon me sukses testin e njohurisë, do të pajiset me një certifikatë përkatëse për një periudhë të vlefshmërisë prej katër (4) vite, të lëshuar nga AAC-ja.

Ky doracak është përgatitur nga AAC si material udhëzues për rregullimin e kësaj fushe të aviacionit.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, ju lutem të kontaktoni AAC, në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

Rruga Zejnel Salihu Nr.22
10000 Prishtinë Republika e Kosovës
e-mail: drones@caa-ks.org
Tel: +383 38 200 74 278
+383 38 200 74 279

Lista e faqeve efektive

Titulli	Faqe	Ver.	Data efektive
Parathënie	2 nga 9	2	11.02.2026
Lista e faqeve efektive	3 nga 9	2	11.02.2026
Tabela e aprovimit	4 nga 9	2	11.02.2026
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	5 nga 9	2	11.02.2026
Tabela e përmbajtjes	6 nga 9	2	11.02.2026
Pyetjet	7 nga 9	2	11.02.2026

Tabela e aprovimit

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Leonora Ibraj Inspektore, DSF	11.02.2026	
Autorizuar nga:	Kushtrim Musa Drejtore, DSF	13.02.2026	
Kontrolli i cilësisë:	Lendita Kika-Berisha Drejtore, DCS	16.02.2026	
Aprovuar nga:	Arianit Islami U. D. Drejtore i Përgjithshëm	18.02.2026	

Lista e distribuimit

Kopje nr.	Vendndodhja	Media	Sasia
1	Libraria e AAC-së	Originali	1
2	Web faqja e AAC-së Serveri i dosjeve të AAC-së	Digjitale	1

Tabela e revidimit

Nr. Rev.	Datë	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:
Versioni 2	11.02.2026	Leonora Ibraj	Kushtrim Musa

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	2
Lista e faqeve efektive	3
Tabela e aprovimit	4
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	5
Tabela e përmbajtjes	6
Lista e pyetjeve	7

Lista e pyetjeve

1. Cili është qëllimi i Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 ?
2. Për cilat lloje të Sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP) nuk zbatohet Rregullorja (AAC) Nr. 01/2026 ?
3. Cila është pesha maksimale e një SAP për të cilin aplikohen dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 ?
4. Cilat mjete ajrore përjashtohen nga dispozitat e Rregullores Nr. 01/2026 bazuar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për aviacionin civil ?
5. Çfarë nënkupton shkurtesa “AAC” ?
6. Çfarë nënkupton shkurtesa “mjet ajror” ?
7. Çfarë nënkupton “objekte ndihmëse komerciale” ?
8. Çfarë nënkupton “leje e KTA-së” ?
9. Operimi përtej vijës së drejtë të shikimit nënkupton ?
10. Çfarë është hapësira e kontrolluar ajrore ?
11. Çfarë nënkupton “operimet e fluturimit” ?
12. Vija e drejtë vizuale nënkupton ?
13. Në sa kategori ndahen SAP ?
14. Ju lutem përshkruani kategorinë A1 të operimeve me SAP ?
15. Ju lutem përshkruani kategorinë A2 të operimeve me SAP ?
16. Ju lutem përshkruani kategorinë A3 të operimeve me SAP ?
17. Ju lutem përshkruani kategorinë A4 të operimeve me SAP ?
18. Një SAP me peshë operative nga 250 gr. deri në 1 kg, hynë në cilën kategori ?
19. Një SAP me peshë operative nga 1 kg deri në 4 kg, hynë në cilën kategori ?
20. Një SAP me peshë operative nga 4 kg deri në 25 kg, hynë në cilën kategori ?
21. Një SAP me peshë operative nga 25 kg deri në 150 kg, hynë në cilën kategori ?
22. Në sa klasë ndahen hapësirat e fluturimit me SAP ?

23. Ju lutem përshkruani klasën e I-rë të hapësirës së fluturimit me SAP ?
24. Ju lutem përshkruani klasën e II-të të hapësirës së fluturimit me SAP ?
25. Ju lutem përshkruani klasën e III-të të hapësirës së fluturimit me SAP ?
26. Ju lutem përshkruani klasën e IV-të të hapësirës së fluturimit me SAP ?
27. Cila është lartësia maksimale të cilën operatori i SAP duhet ta mbajë gjatë fluturimit ?
28. A duhet të mbajë kontakt vizual të drejtpërdrejt operatori me SAP ?
29. A duhet të mirëmbahet SAP para operimit ?
30. Para operimit me SAP pronari/operatori është përgjegjës për ?
31. A mund të bartni mallra me SAP ?
32. A lejohet mbledhja dhe përdorimi i imazheve të objekteve ushtarake apo qeveritare me SAP ?
33. Cili është roli i Policisë së Kosovës dhe KFOR në zbatimin e Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 ?
34. Kush mund të shqiptoj gjobë në rast se shkeljet e Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 raportohen nga KFOR ose Policia e Kosovës ?
35. Për çfarë afati kohor është valid regjistrimi i lëshuar nga AAC?
36. Nëse një SAP është i regjistruar në një shtet të huaj a ka nevojë të regjistrohet edhe në AAC ?
37. Sa ditë paraprakisht duhet të dorëzohet/dërgohet kërkesa për operim me SAP te KANS?
38. Cila është distanca minimale e operimit me SAP nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"?
39. Cila është distanca minimale e operimit me SAP nga bazat ushtarake të NATO ?
40. A mund të operoni gjatë natës me SAP ?
41. Sa ditë më herët duhet të paraqitet kërkesa për autorizim për operim me SAP në ngjarje të veçanta ?
42. Cila është distanca minimale e operimit mbi grumbullime të njerëzve me SAP ?

43. Cila është lartësia maksimale e operimit mbi lartësinë e tokës me SAP ?
44. Sa është distanca maksimale mes operatorit dhe SAP gjatë fluturimit ?
45. Kush është përgjegjës për shenjëzimin e SAP ?
46. A nevojitet polica e sigurimit ndaj palëve të treta për të operuar me SAP ?
47. Çfarë deklarate nënshkruan operatori i SAP ?
48. Si mund të vërtetohet gjendja shëndetësore e kandidatit i cili i nënshtrohet testimit të njohurive për operim me SAP ?
49. Sa është përqindja e përgjigjeve të sakta të cilat ju nevojiten që të kaloni me sukses testin e njohurisë ?
50. Pas sa dite mund ti nënshtroheni testit të njohurisë nëse nuk e kaloni me sukses testin e parë ?
51. Sa është valide certifikata e lëshuar nga AAC për testin e njohurive ?
52. Cili Ligj përcakton masat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave të Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 ?